



01 Nr. 360/26 Dt. 05.08.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës për lejimin e shfrytëzimit të hapësirës tek objekti i Zyrës së Gjendjes Civile në Tusuz, me qëllim të sistemimit dhe arkivimit të lëndëve arkivore të cilat gjenden në objektin e Komunës.
2. Obligohet Drejtoria e Administratës dhe organet tjera përkatëse të Komunës, që bartja dhe sistemimi i lëndëve arkivore nga objekti i Komunës në objektin e Zyrës së Gjendjes Civile në Tusuz të bëhet konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Arkivës së Kryetarit.